



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2021:001455  
Datë: 08.11.2021  
Numri i dokumentit: 02429768

C.nr.14/21

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm - gjyqtarja Mirlinda Bytyqi Rexhepi, në çështjen kontestimore të paditësit Rr.I. nga fshati ... K.Ferizaj, të cilin me autorizim e përfaqëson Av. Islam Musa me seli në Ferizaj, kundër të paditurit S.A. nga fshati ... K.Ferizaj, të cilin e përfaqëson me autorizim Nazmije Ahmeti, ndërhyrësi N.I. të cilin e përfaqëson me autorizim avBurhan Qosa nga Ferizaj, lidhur me pengim posedimin, në prezencën e paditësit dhe të autorizuarit të tij, të autorizuarës së të paditurit dhe ndërhyrësit dhe të autorizuarit të tij, me datë 11.10.2021 mori, ndërsa me datë 8 nëntor 2021 përpiloi me shkrim këtë:

A K T V E N D I M

I.REFUZOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit Rr.I. nga fshati ... K.Ferizaj, e ushtruar kundër të paditurit S.A. nga fshati ... Ferizaj, dhe VËRTETOHET se i padituri S.A. me datë 10.12.2020 nuk i ka penguar paditësit në posedimin e qetë të palujtshmërisë me sipërfaqe prej 3788 m<sup>2</sup>, me numër të ngastrës ... ZK Komogllavë.

II.DETYROHET paditësi që të ndërhyrësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 509€, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit në dorëzim, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Paditësi përmes të autorizuarit të tij me datë 06.01.2021 në këtë Gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurit, lidhur me pengim posedim.

I autorizuari i paditësi në seancat e mbajtura ka deklaruar se mbetet pranë padisë dhe kërkesë padisë, sa i përket padisë se ushtruar ka theksuar se në pasuesin numër 2 është bërë një gabim teknik dhe kërkon që i njëjti pasues të hiqet nga padia dhe atë pjesa ku është shënuar se e ka në shfrytëzim dhe posedim vëllai i tij N.I. Nga ushtrimi i provave është vërtetuar se paditësi është posedues faktik dhe ka në shfrytëzim ngastrën kadastrale nr ... në sipërfaqe prej 3788m<sup>2</sup> ZK ... dhe se kjo ngastër kadastrale në drejtorin e kadastrit të gjeodezisë si pronar është në emër të gjyshit të paditësit I.F.I. i cili ka vdekur me date 03.06.1984. Nga dëshmia e paditësit në cilësi të palës është vërtetuar se ngastra kadastrale ... është e pa ndarë, nuk është bërë ndarja fizike dhe këtë ngastër e ka pasur në posedim dhe shfrytëzim paditësi, se në kohën kur ndërhyrësi vëllai i tij N. një pjesë të kësaj ngastre ia ka shitur të paditurit, paditësi fare nuk është njoftuar për këtë, e sikur të ishte njoftuar i njëjti do ta blinte dhe nuk do ta lejonte që palujtshmëria e tij të ndahet në dy pjesë.

Gjithashtu skica e cila është prezantuar nga ana e ndërhyrësit kinse është bërë ndarja e kësaj palujtshmërie për këtë paditësi nuk ka qenë fare i njoftuar dhe ndërhyrësi e ka bërë pa pëlqimin e tij. Nga pamja në vend që ka bërë gjykata dhe nga ekspertiza që është përpiluar nga ana e ekspertit të gjeodezisë shifet se nëpër mes kësaj ngastre kadastrale ekziston rrjeti i kanalizimit i cili është në gjatësi prej 162.70m dhe ka në të njëjtin rrjet gjinden 4 shakta të kanalizimit e që vërehen dhe ekzistojnë mbi sipërfaqe të tokës. Se në të njëjtën palujtshmëri që ka në posedim paditësi ekziston edhe një rrjet tjetër i kanalizimit që është me ngjyrë të kaltër por i njëjti nuk funksionon, të cilin para disa viteve e ka vendosur Komuna e Ferizajt mirëpo pasi që paditësi është njoftuar ka ndërprerë punën dhe sot e asaj dite është jashtë funksionimit. Se rrjeti i kanalizimit e ka vendosur i padituri pa pëlqimin e paditësit dhe atë me datë 10.12.2020 në ngastrën kadastrale ... ndërsa nga këtu paditësi ka qenë me punë të përkohshme në Zvicër dhe kur është kthyer në Kosovë më datë 20.12.2020 ka vërejtur se është vendosur rrjeti i kanalizimit dhe me vendosjen e këtij rrjeti paditësit i është pa mundur posedimi dhe shfrytëzimi i qetë i kësaj palujtshmërie, në bazë të nenit 111 par 1 të LPDTS-së. Andaj i propozon gjykatës që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit si e bazuar, të vërtetohet se i padituri S.A. nga Fshati ... me datë 10.12.2020 ka penguar paditësin Rr.I. në posedimin e fundit të qetë faktik të palujtshmerisë të evidentuar në ngastrën kadastrale nr ... me sipërfaqe prej 3788 m<sup>2</sup> ZK Komogllave. Të urdhërohet i padituri S.A. që të ndërpresë aktin e pengim posedimit me tërheqjen e rrjetit të kanalizimit në gjatësi prej 162.70m, i vendosur nga ana e të paditurit në ngastrën kadastrale të sipër përmendur e që ka në posedim faktik dhe të mos i pengoj në posedimin e lirë të kësaj ngastre. I kërkojnë shpenzimet e procedurës dhe atë për përpilimin e padisë 104€, për taksë gjyqësore 50€, për përfaqësim të avokatit për 5 seanca të

mbajtura nga 135€ për seancë, për një seancë të shtyrë 65 euro, dhe për ekspertizë të gjeodezisë 150€ gjithsej shumën prej 1040€.

Përfaqësuesja e të paditurit ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi duke e kontestuar padinë si të pa themeltë dhe të pa bazuar, pasi paditësit i mungon legjitimiteti aktiv dhe për këtë arsyeje i propozon gjykatës që padinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pa themeltë dhe të pa bazuar dhe ta obligoj paditësin që në të ardhmen të mos e pengon të paditurin në shfrytëzimin e parcelës që e ka blerë në mënyrë të rregullt nga shitësi.

Gjithashtu në përgjigje në padi ka theksuar se paditësi përfshirë provat e bashkangjitura në padi vërtetojnë se i njëjti është posedues faktik i vetëm  $\frac{3}{4}$  të ngastrës kadastrale ..., ndërsa në  $\frac{1}{4}$  të ngastrës së njëjtë kadastrale pushtetin faktik dhe në shfrytëzim e ka vëllai i paditësit N.I. Paditësi nuk e ka dëshmuar se ishte i autorizuar në ndonjë mënyrë nga poseduesi faktik i  $\frac{1}{4}$  së ngastrës kadastrale N.I. për të paraqitur padi në emër dhe për interesa të tij. I padituri nuk e konteston faktin se paditësi është shfrytëzues i  $\frac{3}{4}$  të ngastrës kadastrale së bashku me vëllain e tij N.I. që është posedues fakt/shfrytëzues i  $\frac{1}{4}$  të së njëjtës ngastër kadastrale. Por e konteston padinë mbi bazën e kontestimit të pushtetit faktik të fundit të tërësishëm të ngastrës kadastrale nr.... me sipërfaqe 3788m<sup>2</sup>, sepse për  $\frac{1}{4}$  të ngastrës kadastrale poseduesi i fundit faktik është N.I. – vëllai i paditësit, i cili e mban në posedim faktik këtë ngastër mbi të njëjtën bazë juridike. I padituri e ka blerë  $\frac{1}{4}$  të ngastrës nga N.I., vë vlerë prej 6,500€ të cilat i ka paguar në tërësi me dy këste dhe shitësi personalisht i ka bërë ofertë për blerje të padituri sipas deklarimit të tij ai së pari i ka bërë ofertën për blerje të kësaj pjese vëllezërve të tij, por ata kanë deklaruar se nuk janë të interesuar për blerje të kësaj ngastre.

Poseduesi faktik i fundit N.I. më datë 03.06.2019 pjesën prej  $\frac{1}{4}$  së parcelës ia ka shitur të paditurit për shkak se shfrytëzuesi N.I. nuk e ka pasur këtë pjesë të regjistruar në emër të vet, sikur që është gjendja e ngastrës në tërësi, marrëveshja e shitblerjes është bërë në mënyrë gojore dhe për këtë parcelë i padituri e ka paguar kundërvlerën në të holla. Me rastin e marrëveshjes dhe pagesës së çmimit të kontraktuar blerësi është bërë posedues dhe ka pasur mundësi menjëherë që të ushtrojë pushtetin faktik mbi këtë pjesë të parcelës me 947m<sup>2</sup>. Kështu që i propozon gjykatës që padinë e paditësit ta refuzoj si të pa themeltë dhe të pa bazuar.

Ndërhyrësi N.I. nga fsh ... K. Ferizaj më datë 13.03.2021 përmes të autorizuarit të tij av. Burhan Qosa ka parashtrua një parashtrësë me anë të cilës ka kërkuar që në këtë çështje të jetë si ndërhyrës i thjeshtë dhe më tutje të konsiderohet si palë me interes juridik në çështjen civile-

kontestimore, sipas padisë së paditësit Rr.I. që ka të bëjë me padi për shkak të pengim posedimit , në pasurinë e palujtshme, në parcelën me njësi kadastrale me nr... ZK Komogllavë në sipërfaqe prej 3788m<sup>2</sup>, në të cilën parcelë në pjesën ideale prej ¼ të saj është posedues faktik S.A. që nga viti 2019 e të cilën sipërfaqe toke e ka blerë nga tani ndërhyrësi N.I.

Naim Ismajli në ngastrën kadastrale nr...0ZK Komogllavë në sipërfaqe prej 3788m<sup>2</sup>, në të cilën parcelë në pjesën ideale prej ¼ të saj, ishte posedues faktik N.I. dhe atë deri më datë 03.06.2019 e pastaj ia ka shitur të paditurit S.A. nga fsh... Duke shtuar se nuk është kontestuese përgjigja në padi se N.I. ia ka shitur pjesën e tij prej ¼ të paditurit S.A. po ashtu edhe çmimin ia ka paguar në tërësi dhe pas pagimit ka hyrë në posedim të asaj pjese. N.I. ka njoftuar se për shitjen e asaj pjese kanë qenë në dijeni edhe vëllezërit e tjerë Rr., N., M.I., pasi që para se ta shiste pjesën e tij të paditurit fillimisht ua kishte ofruar vëllezërve të tij për ta blerë atë, por asnjëri nga a nuk ishin të interesuar për ta blerë ku dhe N.I. secili nga vëllezërit veç e veç i kishin dhënë leje për të ia shitur kujtdo tjetër.

Gjykata në seancën e datës 29.07.2021 ka aprovuar propozimin dhe N.I. i njihet e drejta e ndërhyrësit të thjeshtë në këtë çështje kontestimore pasi vlerësoi se i njëjti ka interes juridik në këtë çështje.

I autorizuari i ndërhyrësit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e kundërshton fjalën përfundimtare të përfaqësuesit të paditësit pasi që është në kundërshtim me nenin 480 të LPK-së dhe se asgjë nuk lidhet me objektin e kontestit. Duke shtuar se pas administrimit të provave është vërtetuar se ndërhyrësi ka qenë posedues faktik i parcelës objekt shqyrtimi nëpër të cilën i padituri S.A. qoftë personalisht apo edhe me ndihmën e komunës ka shtruar kanalizimin nëpër atë parcelë, konsideron se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore e sidomos pas dëgjimit të dëshmitarit N.I. i cili ka deklaruar se prona objekt shqyrtimi nga ndërhyrësi tek pala e paditur është shitur me dijeninë e të gjithë vëllezërve përfshirë edhe paditësin dhe ajo pronë është shitur vetëm kur vëllezërit e ndërhyrësit nuk kanë shprehur interes për të blerë, andaj duke u nisur nga fakti se paditësi nuk ka legjitimitet aktiv të ushtroj padi për pengim posedimi sepse është i çartë definicioni i dispozitës ligjore nga neni 480, baza e të cilës përjashtohet mundësia e shqyrtimit lidhur me të drejtën e shqyrtimit, bazën juridike, ndërgjegshmërinë ose pa ndërgjegshmërinë mbi këtë bazë dhe konform asaj që është proceduar në këtë çështje, ku vërtetohet se i padituri Sabri Ahmet përveç asaj që me të gjitha bazat ligjore ka qenë posedues i fundit faktik i parcelës objekt shqyrtimi. Rezulton qartë se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me pengim posedimi dhe po ashtu edhe sikur të kishim paditësi do të kishte humbur afatin

partitiv për të parashtruar padi në afatin prej 30 ditësh nga dita kur është vënë në dijeni për shitblerjen e asaj palujtshmërie. Konsideron se gjykata duhet ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar dhe shton se është absolutisht e pa mundur dhe nuk duhet ti falet besimi deklarimit të përfaqësuesi të paditësit sepse par 2 është gabim teknik për arsyet se një gjë e tillë do të ishte bërë me parashtrësë gjatë seancës përgatitore. Prandaj kërkojnë nga gjykata që gjykata që ta refuzoj kërkesë padinë si të pa bazuar dhe të njëjtin ta detyroj që ndërhyrësit ti paguaj shumën e shpenzimeve procedurale në shumën prej 509€ dhe atë në emër të përpilimit të parashtrësës për ndërhyrje 104€ dhe për tri seanca të mbajtura nga 135€ një seancë.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes së fakteve të çështjes, për aq sa palët ndërgjyqëse përmbushin detyrimin e tyre për t'i parashtruar ato, në kuptim të nenit 7.1 të LPK-së, ka administruar një sërë provash: certifikata e pronësisë në emër të I.F.I., skica, përgjigje në padi, ekspertiza e gjeodezisë e datës 22.02.2021, parashtrësë për ndërhyrje e datës 16.03.2021.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve dhe provave të lartëcekura, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar në tërësi, dhe vërtetoi këtë gjendje faktike:

Gjykata vlerëson se paditësi padinë e tij e ka parashtruar brenda afatit ligjor të paraparë në dispozitat e nenit 114 Shuarja e kërkesës të LPDTS, në të cilën dispozitë përcaktohet se “*Kërkesa mund të parashtrohet vetëm në afatin prej 30 (tridhjetë) ditësh, pasi që poseduesi e merr dijenin lidhur me privimin apo pengimin e posedimit të tij. Kërkesa shuhet pas kalimit të një viti nga privimi ose pengimi i posedimit*”, për arsye se fakti i pengim posedimit ka ndodhur me 10.12.2020, ndërsa padinë e kanë ushtruar me datë 06.01.2021.

Po ashtu padia e paditësit i përmban elementet thelbësore të parapara në nenin 253 dhe 480 të LPK-së, dhe atë veprimet e pengim posedimit, kohën, vendin.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor datë 05.08.2021 u ftua të dëshmoj paditësi në cilësinë e dëshmitarit i cili ka deklaruar se S.A. e njeh vetëm si fshatar dhe nuk ka raporte familjare duke shtuar se jeton në fshatin ...ë lagjia N., kurse lagjia M.A. është një lagje më larg ku e ka një parcelë rreh 3.5 ari nga një kushëri që quhet S.I., pastaj e ka blerë edhe 15 ari e 17m prej një kojshie dhe ngjit është kanalizimi i parë. Ka deklaruar se posedon edhe 9 ari të cilat i ka blerë

nga kusherit dhe aty gjendet parcela 2639-0 të cilën e ka blerë vet para luftës, N.I. ja ka shitur Sabris dhe asnjëri prej tyre nuk e ka njoftuar, kjo parcelë ka qenë e 4 vëllezërve.

Më datë 10.12.2020 është kthyer nga Zvicra dhe e ka vërejtur se kanalizimi është aty, pastaj ka shkuar dhe e ka prerë të gjithë malin dhe ka shkuar tek i padituri dhe i ka thënë nuk bëhet kjo thirrë at zotërinë, se kush e ka filluar ta bëjë atë rrjet të kanalizimit e ka kuptuar nga S.I. Ajo tokë nuk është punuar asnjëherë e sidomos prej hapjes së kanalizimit të parë, në atë parcelë ka dy hise nga 9 ari e gjysmë, njëra është e tyre, ndërsa tjetrën e ka djali i mixhes, dhe posa ka kuptuar që kjo shitblerje është bërë e ka thirrur në telefon të paditurin dhe i ka thënë që ky pazar është i dështuar. Parcelat i ka punuar të gjitha vet paditësi dhe pasi është vendosur kanalizimi i pengon pasi që parcela është në mes të arave dhe e ndanë me parcelën tjetër, kjo parcelë është e pa ndarë dhe së pari i takon paditësit për ta blerë dhe pastaj të tjerëve. Paditësi e ka thirrur në telefon të paditurin për ti treguar se ky pazar është i dështuar dhe se prona nuk është në shitje, pasi që vëllai i tij ka dashur t'ia shet edhe tjetër kujt pronën por nuk e ka lejuar pasi nuk komunikojnë me vëllaun dhe për këtë arsyeje nuk kanë mundur ti zgjidhin problemet mes vete.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 05.08.2021 u ftua të dëshmoj N.I. në cilësinë e dëshmitarit i cili ka deklaruar se Rr. e njeh pasi të njëjtin e ka vëlla kurse S. e ka katunar. Duke shtuar se kanalizimi që është objekt kontesti ka kalon nëpër parcelën që e ka në posedim dhe shfrytëzim në pjesën 1/4 të parcelës dhe këtë pjesë të parcelës ia ka shitur S.A. në vitin 2019 dhe çmimin e ka paguar në tërësi në shumën prej 6500€. Parcela ka një numër kadastral por ndarjen e dinë pasi që babai i tyre i ka ndarë kufijte e secilës parcelë por juridikisht nuk janë të cekur kufijte dhe kështu që parcela ka mbetur e pa ndarë, parcela ndahet në 4 pjesë nga 9.5 ari dhe parcela ku ka filluar kanalizimi ka qenë e bablokut dhe kjo pronë i ka takuar dëshmitarit. Kur ka vendosur ta shes tokën fillimisht e ka pyetur Rr. nëse është i interesuar që ta blejë dhe i ka thënë që nuk dëshiron që ta blejë dhe nuk e ka kundërshtuar shitjen e tokës, por pasi e ka shitur Rr. është hidhëruar se e ka shitur tokën dhe kur është kthyer nga Zvicra e ka prerë gjithë malin me miqtë e vet pastaj e kanë thirrur policin dhe ja kanë ndërpre punën.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të 11.10.2021 u ftua të dëshmoj dëshmitari N.I. i cili ka deklaruar Rr.I. e njeh pasi e ka vëlla, kurse S.A. e njeh pasi e ka katundar dhe ndërhyrësin N.I. e ka vëlla, duke shtuar se prona kontestuese është në fshatin ..., e cila pronë ka qenë e vëllaut të tij N.I. të cilën pronë e kanë si trashëgimi familjare. Rr. e ka ndërtuar një shtëpi pa lejen e babait dhe për këtë arsye babai i kishte thënë që Rr. nuk ka hise tjetër, vëllau i vogël M. është

ndarë nga bashkësia familjare dhe e ka marrur hisen e vet, kështu dëshmitarit N. dhe vëllaut N. i ka mbetur pjesa tjetër dhe ajo pronë ku është ndërtuar kanalizimi i ka takuar N., kjo ndarje ka ndodhur me marrëveshjen e tre vëllezërve N., N. dhe M.. Kur e ka shitur token N. i ka pyetur të gjithë vëllezërit dhe pastaj ja ka shitur S.A., dhe kur i ka pyetur të gjithë asnjëri nga vëllezërit nuk e ka kontestuar duke përfshirë këtu edhe Rr., për të cilin i ka treguar vëllau N. dhe M. të cilët kanë shkuar tek banesa e tij për ta pyetur nëse do që ta blejë tokën e N.. Kanalizimi ka filluar që të hapet nga komuna dhe me iz të Rr. e kanë ndërprerë.

Në ekspertizën e gjeometrit I.Z. të përpiluar me datë 22.02.2021 eksperti ka konstatuar se me urdhër të trupit gjykues është bërë inqizimi i gjendjes faktik, duke përfshirë që ka përreth vijës kufitare dhe hapësirat ku është punuar kanalizimet fekale si i vjetri dhe i riu. Gjykatës i prezantohet gjendja faktike me koordinata dhe shenja të pusetave.

-Kanalizimi fekal i vjetër- pas identifikimit dhe matjes shifet se i njëjti është në gjatësi 145m në thellësi 1m nga pika e fillimit të kyçjes në kanalizimin kryesor deri te puseta afër shtëpisë së të paditurit në thellësi afër 3m, i njëjti është jashtë përdorimit, gypi nuk shifet se në çfarë diametri është. Në hapësirën ku është ekzekutuar ky kanalizim, tani kjo pjesë pjesërisht është e pa shfrytëzuar për bujqësi pasi që është e mbuluar me therra gjembore.

-Kanalizimi fekal i ri - Pas identifikimit dhe matjes shifet se i njëjti është në gjatësi 162m, në thellësi 1m nga pika e fillimit të kyçje në kanalizimin kryesor deri te puseta afër shtëpisë së të paditurit në thellësi afër 3m shifet se janë të vendosura 4 puseta, i njëjti është në përdorim. Në hapësirën ku është ekzekutuar ky kanalizim tani kjo pjesë pjesërisht është e pa shfrytëzuar për bujqësi pasi që është e dëmtuar gjatë ekzekutimit të punimeve.

Në seancën e datës 05.08.2021 eksperti I.Z. ka deklaruar se mbetet pranë ekspertizës së punuar duke shtuar se sipas shënimeve zyrtare të laboratit kadastral në pjesën shkruese dhe në pjesë teknike parcela ... është e pa ndarë dhe se e njëjta figuron në kuadër të masave dhe kufijve të ingjizimit fotogrametik të vitit 1958, dhe se e njëjta parcelë është e evidentuar në emër të I.I.(F.).

Gjatë gjykimit të padive posedimore paditësi duhet të provojë se është posedues i fundit i sendit, e në rastin konkret paditësi nuk ka provuar që është posedues i fundit, fakt i pohuar edhe nga vetë i padituri dhe ndërhyrësi dhe mbi këtë bazë nuk ka mundur ta shqetësoj apo t'i deposedoj paditësin nga posedimi. Veprimi i pengim posedimit tek paditësi është vendosja e rrjetit të kanalizimit, që e pengon paditësin në shfrytëzimin e parcelës së tij, mirëpo në rastin

konkret parcela ... ZK Komogllavë është parcelë e pandarë e cila parcelë është e regjistruar në emër të pronarit Ismajl Ismajli, ndërsa palët ndërgjygjëse nuk kanë mundur ta vërtetojnë faktin se janë posedues të asaj parcelë, pasi paditësi pretendon se ai është posedues i asaj parcelë e njëjtë pretendon edhe ndërhyrësi.

*Baza Ligjore* :Në nenin 103 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat e Tjera Sendore parashihet “*Personi i cili e ushtron pushtetin faktik mbi një send është posedues i drejtpërdrejtë*”, në nenin vijues 104 të të njëjtit ligj parashihet “*Posedimi në një sendi fitohet me krijimin e pushtet faktik mbi sendin. Marrëveshja e poseduesit të mëparshëm dhe e fituesit të posedimit është e mjaftueshme për fitimin e posedimit, nëse fituesi është në gjendje që të ushtrojë pushtetin mbi sendin në momentin e marrëveshjes*”. Poseduesi i sendit ka të drejtë që të parashtojë padinë për pengim posedim kundër personit që ka cenuar posedimin, Pra, padia e pengimit të posedimit parashtrohet kundër personave të cilët cenojnë posedimin e një sendi, nëpërmjet veprimeve që shkaktojnë shqetësime ose që pengojnë në ushtrimin e të drejtës së posedimit. Në nenin 107 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat e Tjera Sendore Nr. 03/L-154 parashihet “*Posedimi shuhet kur poseduesi heq dorë nga pushteti faktik mbi sendin ose në ndonjë mënyrë e humb pushtetin faktik*”. Në nenin 113.1 të të njëjtit ligj parashihet “*Nëse poseduesi privohet nga posedimi në mënyrë të kundërligjshme, poseduesi mund të kërkojë rivendosjen e posedimit prej personit ndërhyrës, i cilinë raport me poseduesin është në posedim me të meta*”.

Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPDTS), në nenin 111 par. 1 përcakton se: “*Personi i cili e privon nga posedimi poseduesin ose e pengon në posedim kundër vullnetit të poseduesit vepron kundërligjshëm, përveç nëse privimi ose pengimi lejohen shprehimisht me ligj*”. Me nenin 113 par.1 të këtij ligji është paraparë se “*nëse poseduesi privohet nga posedimi në mënyrë të kundërligjshme, poseduesi mund të kërkojë rivendosjen e posedimit prej personit ndërhyrës...*”, ndërsa në paragrafin 2 të tij ceket se “*nëse poseduesi pengohet në posedim në mënyrë të kundërligjshme, atëherë poseduesi, mund të kërkojë nga penguesi mënjanimin e pengesave. Nëse priten pengime në të ardhmen, poseduesi mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore*”. Në bazë të provave të administruara në këtë procedurë, nuk është provuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, prandaj e njëjta duhet të refuzohet në tërësi e pa bazuar sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi. Kjo për faktin se në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar në këtë procedurë, nuk është provuar fakti se paditësi ka qenë në posedimin e fundit të parcelës kontestuese. Përmes daljes së gjykatës në vendshiqim është konstatuar se vendi është parcelë dhe në atë hapësirat është punuar kanalizimet fekale si i vjetri dhe i riu.



Gjykata ka pasur parasysh se ngastra kadastrale është parcelë- oborr, prandaj posedimi i fundit nuk duhet të ngatërrohet me të drejtën në pronësi dhe trazimin në pronësi (padi negatore). Ky vlerësim i gjykatës, është në përputhje me nenin 408 të LPK-së, që mes tjerash përcakton të bëhet vlerësimi i fakteve lidhur me posedimin e fundit, e po ashtu në përputhje me nenin 111 të LPDTS.

Gjykata me dëgjimin e të paditësit në cilësi të palës, gjeti se ai nuk banon në atë parcelë, por në një pjesë tjetër, dhe atë paditësi ka deklaruar se jeton jashtë shtetit të Kosovës (fakt ky i pa kontestuar në mes të palëve), prandaj paditësi nuk e ka shfrytëzuar këtë parcelë në mënyrë të vazhdueshme. Gjithashtu nuk është paraqitur ndonjë fakt apo provë përgjatë procedurës, se i padituri të këtë ndërmarrë ndonjë veprim në drejtim të pengimit të paditësit në shfrytëzimin e parcelës ndaj paditësit, pasi paditësi vet ka pranuar faktin se nuk jeton në atë parcelë

Në vijimësi të këtij vlerësimi, sipas nenit 7 par. 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, “ *palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla* ”, andaj gjykata është e lidhur vetëm me propozimet dhe provat të cilat i propozojnë palët ndërgjyqëse, siç edhe është vepruar në rastin kontestues, kurse pala paditëse, nuk ka paraqitur ndonjë mjet provues të besueshëm që më të vërtetë ka ndodhur akti i pengimit në posedim. Si përfundim, për gjykatën në këtë procedurë ka qenë irelevant fakti se në emër të kujt evidentohet ngastra kadastrale, por në vlerësimin e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit. Përcaktimi nga pala paditëse që të drejtën e mbrojtjes së pronësisë të bëjë përmes institutit të pengimit në posedim, nuk është përputhje me vet karakterin normativ që i është dhënë këtij instituti.

Gjykata me rastin e refuzimit të padisë për shkak të pengim posedimi është kufizuar vetëm në konstatimin dhe provuarit të fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe pengimit të bërë siç përcaktohet në nenin 480 të LPK-së si dhe dispozitat e nenit 113 par.2 të Ligjit mbi Pronën dhe të Drejtat Sendore.

Nga deklarimi i palëve ndërgjyqëse, dëshmitarëve dhe provave të administruara në këtë procedurë Gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike se i padituri S.A. nga fshati ..., Komuna Ferizaj nuk e ka penguar paditësin në posedimin e qetë të palujtshmërisë më numër të ngastrës ... ZK Komogllavë, andaj edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata i analizoi edhe theksimet e paditësi, i cili i propozoj gjykatës që kërkesë padinë e paditësit ta aprovoj si të bazuar, këto theksime gjykata i morri si të pa bazuara pasi që vërtetoi se paditësi në asnjë moment nuk kanë arritur që ti argumentojnë theksimet e tyre si me prova ashtu edhe në deklaratimet e tij gjatë seancave gjyqësore andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata i analizoi edhe theksimet e të autorizuarës të paditurit dhe të autorizuarit të ndërhyrësit i cili i propozoj gjykatës që kërkesë padinë e paditësit ta refuzoj si të pa bazuar, këto theksime gjykata i morri si të bazuara andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e detyroi palën paditëse që të autorizuarit të ndërhyrësit të ja paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 509€ edhe atë: 104€ për përpilimin e parashtresës për ndërhyrje dhe për 3 seanca të mbajtura shumë nga 135€, gjykata vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e ka bazuar në nenin 452.1,453 dhe 449 të LPK-së.

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, bazuar në nenin 142.2; 480 dhe 481 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**  
C.nr. 14/21, me datë 8 nëntor 2021

Gjyqtarja

Mirlinda Bytyqi Rexhepi

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7ditësh nga dita e nesërme pas pranimit të të njëjtit në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e të dorëzohet përmes kësaj Gjykate.